



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.507/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Hidajete Gashi Alaj, kryesuese, Kujtim Pasuli dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesat e Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuuese-BIRN me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Popullore Serbe, me seli në Fshati Budrigë e Poshtme, Komuna e Parteshit dhe subjektit politik Lista Serbe me seli në Graçanicë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, gjatë ditës së votimit, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.02.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHEN të pabazuara ankesat A.nr.507/2025 dhe A.nr.509/2025 e datës 10.02.2025, e parashtruar nga Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuuese-BIRN, me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Popullore Serbe, me seli Fshati Budrigë e Poshtme, Komuna e Parteshit dhe subjektit politik Lista Serbe me seli në Graçanicë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, gjatë ditës së votimit, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Me datën 10.02.2025 PZAP ka pranuar ankesat A.nr.507/2025 dhe 509/2025, nga Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuuese-BIRN, me seli në Prishtinë. Në ankesën A.nr.507/2025 pretendohet se nga një foto e bërë nga gazetari i KALLXO.COM shihet se Lëvizja Popullore Serbe afër qendrës së vendvotimit 3602 në fshatin Brigadë e Poshtme, ka vendosur vizitë - kartela e Lëvizjes Popullore Serbe e vendosur afër qendrës së votimit Budrigë e Poshtme, si provë ka bashkangjitur foto dhe CD në të cilën pretendon se shihet vizitë – karta e vendosur e cila CD nuk gjendet në shkresat e lëndës.

Në ankesën A.nr.509/2025 pretendohet se Monitoruesit e KALLXO.COM në shkollën “Krajl Milutin” në qendrën e votimit 3401 në Graçanicë, kanë vërejtur postera të subjektit politik Lista Serbe. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi.

Për ankesën A.nr.507 subjekti politik Lëvizja Popullore Serbe nuk ka dhënë përgjigje në ankesë.

Në përgjigjen për ankesën A.n.r.509/2025 theksohet se, nuk kanë vepruar në kundërshtim me ligjet dhe rregulloret që rregullojnë veprimtarinë zgjedhore. Në vendvotim nuk kishte shpërndarje të materialeve propagandistike politike dhe as aktivitete që mund të kuptoheshin si të tilla. Të gjitha procedurat në vendvotim janë kryer në përputhje me ligjin dhe nën mbikëqyrjen e plotë të organeve përkatëse zgjedhore, duke respektuar të gjitha rregulloret dhe procedurat e përcaktuara me Ligjin e Përgjithshëm për Zgjedhje. Lidhur me fotot që kanë dorëzuar si provë, pranojmë se në to shihet kartëvizita e një prej kandidatëve tanë. Megjithatë, theksojmë se këto kartëvizita janë shtypur në numër të madh, në qindra kopje dhe janë shpërndarë në kuadër të fushatës zgjedhore. Duke qenë se ato janë shpërndarë në një rreth të gjerë njerëzish, ekziston mundësia që kartëvizita t'i ketë rënë aksidentalisht nga duart një votuesi që e kishte kartën në posedim pa asnjë lidhje me fushatën. Gjithashtu, duam të theksojmë mundësinë që kundërshtarët politikë, të cilët kanë mundur shumë lehtë me i marrë këto kartëvizita, kanë mundur qëllimisht të vendosin një prej tyre në atë vend për të krijuar përshtypjen se ajo ishte e lidhur me fushatën tonë dhe në këtë të tentojnë ta dëmtojnë subjektin tonë politik. Në këtë kontekst, ne besojmë se është jashtëzakonisht e rëndësishme që të analizohet e gjithë situata me kujdes dhe të merren parasysh të gjitha rrethanat e mundshme.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr. 01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi I të Ligjit Nr. 05/1,-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ankesat e evidentuara me numrat si ne vijim: A.nr.507/2025, A.nr.509/2025, të datës 10.02.2025, janë bashkuar dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.507/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese-BIRN, me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Popullore Serbe dhe subjektit politik Lista Serbe, për shkeljen e njëjtë, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore gjeti se:

Ankesat janë te pabazuara.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës se subjektet politike Lëvizja Popullore Serbe dhe Lista Serbe, kanë shpërndarë material vizitë - karta dhe atë afër qendrës së votimit 3602 në fshatin Budrigë e Poshtme dhe në Shkollën "Krajl Milutin" në qendrën e votimit 3401 në Graçanicë, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 37 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.08/L-228 i cili përcakton "1. Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë: shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në

ndonjërën nga Qendrat e Votimit, dhe oborri i së njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi te votuesit; bërja e fushatës në çfarëdo mënyre” pasi që në fotografit e bashkangjitura për ankesën A.nr.507/2025 nuk mund të identifikohet vendi i vendosjes se kartave, ndërsa lidhur me ankesën A.nr.509/2025 mund të identifikohet nga fotografia e parë në ankesë se është qendra e votimit 3401 për nuk dihet së është objekti i shkollës “Krajil Milutin” për të cilën pretendon ankuesi.

Në bazë të provave të bashkangjitura shkresave të lëndës dhe pretendimet e palës ankuese paneli vlerësoi se pretendimet ankimore lidhur me ankesat A.nr.507/2025 dhe A.nr.509/2025 për shpërndarjen e kartave/afisheve afër qendrave të votimit dhe si të tilla Paneli i refuzoi për faktin se Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese-BIRN nga veprimet e përshtuara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi, nuk ka arritur që të vërtetoj se këto veprime janë ndërmarr nga subjektet politike kundër të cilave janë paraqitur ankesat, për të ardhur në përfundim se janë bërë shkelje nenit 37 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.08/L-228 i cili përcakton “1. Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë: shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërën nga Qendrat e Votimit, dhe oborri i së njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi te votuesit; bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”, ku në rastin konkret parashtruesi i ankesës nuk ka arritur të vërtetoj se vizitë - kartat janë vendosur nga subjektet politike afër objekteve të përmendura në ankesë, andaj ne prani te këtyre rrethanave ankesa është refuzuar si e pabazuar.

Kështu qe paneli vlerësoi se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret të provuarit e asaj se subjektet politike kanë vendosur material vizitë - karta me qëllim të ndikimit te votuesit, apo bërja e fushatës në çfarëdo mënyre në hapësira të palejuara konkretisht afër Qendrave të votimit, nuk është dëshmuar me prova nga pala ankuese, se subjektet në fjalë i kanë vendosur këto vizitë karta.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.507/2025, datë 12.02.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.